Organization for Security and Co-operation in Europe
Presence in Albania

Public Affairs and Media Office
Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe e Medias

DEKLATAE PER SHTYP

OSBE-ja nxit Shqipërinë dhe Malin e Zi për bashkëpunim në zbatimin e ligjit në luftën kundër trafikimit dhe krimit të organizuar

TIRANE, 15 nëntor 2007 – Nxitja e bashkëpunimit mes policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve të Shqipërisë dhe Malit të Zi, në luftën e tyre kundër krimit të organizuar ndërkombëtar ishte fokusi i një takimi të organizuar nga OSBE-ja, i cili përfundoi sot në qytetin e Shkodrës.

Aktiviteti dy ditor u organizua nga kryesia Spnajolle e rradhës së OSBE-së dhe Zyra për Cësthje Strategjike të Policisë me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së dhe Misionit në Malin e Zi.

"Ne diskutuam rreth mekanizmave të përdorura në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikut njerëzor, si dhe rreth rrugëve se si t'i përmirësojmë ato," tha Kevin Carty, Këshilltar i Lartë për Policinë për OSBE-në. "Rezultatet e diskutimeve do t'u shërbejnë jo vetëm këtyre vendeve por edhe gjithë vendeve anëtare të OSBE-së."

Përfaqësues të gjyqësorit, zyrës së prokurorisë dhe policisë nga të dy vendet morën pjesë në diskutim, i cili kishte për qëllim të zhvillonte më tej përpjekjet për koordinim mes këtyre institucioneve dhe ju dha pjesëmarrësve një mundësi për të diskutuar praktikat më të mira dhë fushat për përmirësim.

Takimi u parapri nga takime të tjera të mbajtura në Mal të Zi dhe Shqipëri. Më 12 dhjetor perfaqësues nga të dy vendet do të takohen me ekspertë të OSBE-së në Vienë për të prezantuar një dokument përfundimtar mbi praktikat e mira, të cilat do t'u vihen në dispozicion të 56 vendeve pjesëmarrëse të OSBE-së.

Projekti po implementohet me ndihmën e Prezensës së OSBE-së në Shqipëri dhe Misionit në Malin e Zi.

For more information please contact the **Public Affairs and Media Office** of the **OSCE Presence in Albania**, Sheraton Tirana Hotel & Toëers, 1st Floor, Sheshi "Italia", Tirana, Albania, Tel: +355 4 235 993, fax: +355 4 244 204, e-mail: pamo-al@osce.org, ëebsite: ëë.osce.org/albania